



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 28**

**Datë: 16. 06. 2020. Ora: 14:00**

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Nenad Rikalo, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

**RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.25/2020.

**2. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

- **Këshilli për Personel:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Rekrutimit për vitin 2020:

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit “Analizë e votave me asistencë për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, 6 tetor 2019”,

- **Këshilli për Çështje Ligjore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Klinë, Pejë dhe Prishtinë.

**3. Të ndryshme.**

---

**1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

**Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.25/2020.**

**Valdete Daka**: Mirë se keni ardhur në mbledhjen nr. 28. A kemi vërejtje në rendin e ditës ?

**Sami Kurteshi**: Kam marrë një rendi dite në mënyrë elektronike, por nuk është këshilli për personel...Kam edhe një tjetër...

**Valdete Daka**: Këshilli nuk është mbajtur, nuk ka mundur të takohet, sepse kryesuesi nuk ka qenë prezent...

**Alim Rama**: Unë, e kam dërgue rendin e ditës dhe një pikë KOZ-in, dhe nuk është e përfshirë...Kjo pikë, ka të bëj me rivlerësimin e gjendjes në Podujevë. KOZ-i e ka votue, fatkeqësisht me banalitetin e votës ton, me 1 votë për, dhe me 3 vota t'abstenueme. Ka rekomanduar mu ba diskutimi, edhe ndikimi në aspektin operacional të shtyrjes së zgjedhjeve në Podujevë. K'to, janë paraqitë edhe në imel, dhe se kuptoj se në çfarë mënyre, kjo nuk a përfshirë në rendin e ditës...

**Valdete Daka**: Me sa kuptoj unë, me 1 votë, nuk a shumica...Shumica është tre, nëse një këshillë i ka pesë anëtarë.

**Alim Rama**: Nuk ka asnjë kundër, duhet mu deklarue: a është për, kundër, abstenon...Çështja u bartë në votim...unë po shoh: qe disa mbledhje me radhë, kjo temë po refuzohet të shqyrtohet në KQZ...

**Valdete Daka**: Lëreni KOZ-in, me 1 votë për, nuk mundet me qenë kurrë shumicë, prandaj a ke ndonjë propozim shtesë për rend dite...Nëse ke propozim...? Se, po na e përsëritë të njëjtën temë, qe katër herë e kemi diskutue, madje jashtë rendit të ditës...

**Alim Rama**: Unë nuk po e kuptoj se pse në mënyrë autoritare, po e caktoni rendin e ditës...!

**Valdete Daka**: A ke propozim ?

**Alim Rama**: “Diskutimi për kërkesë ISHPK-së për rivlerësimin e gjendjen epidemiologjike në Podujevë në rrjedhshmëri me vendimet e mëparshme që kanë ardhur nga ISHPK”

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Arianit Elshani, Sami Kurteshi,

**Valdete Daka:** Nuk është kopmetencë e jona me diskutue: a duam, apo nuk duam zgjedhje. Ne organizojmë zgjedhje, sa herë që na kërkohet... E hedh në votim propozimin e Alimit. Kush është për këtë propozim ?

Janë, 5 vota kundër, 2 vota për, 3 vota abstenim...

Bazuar në votim, kjo pikë e propozuar nuk hynë në rend dite. Në vazhdim, u miratua rendi i ditës me 10 vota për, dhe 1 votë kundër (Alim Rama).

## **2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet nr.25 dhe 26 /2020**

Procesverbalet, u aprovuan në mënyrë unanime.

### **3. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

#### **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit “Analizë e votave me asistencë për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, 6 tetor 2019”:

**Alim Rama:** E falenderoj Sekretariatit për analizë të detajuar, e cila i ka trajtuar të gjitha votat me asistencë në mënyrë detale, të strukturuar dhe të saktë. Kjo analizë, jep disa rekomandime për KQZ -në të cilat, duhet me u përfshie në procesin e ardhshëm zgjedhor. Raporti cekë disa mangësi nëpër komuna, ku ka pasur gati 20% vota me asistencë, dhe kjo, realishtë duhet minimizuar në të ardhmen. Mendoj që janë rekomandime të qarta, dhe besoj që vota me asistencë duhet të trajtohet me një takim me organizatat jo qeveritare, në një tryezë të hapur të trajtohen...

KOZ, e ka miratuar në mënyrë unanime këtë analizë, dhe rekomandon për aprovim.

**Sami Kurteshi:** E kam parë raportin, dhe është një analizë shumë e mirë, e detajuar bazuar në bruimin e trajtuar. Personalisht, këto edhe janë analizat që unë i presë në të ardhmen, e që duhet tu përcillen edhe institucioneve të tjera...

**Yll Buleshkaj:** Analiza, është bërë nga një ekipë i përbashkët... Por, është pak e cuditshme se si, në dy komuna të vogla ka kësi problem...

Arianit Elshani: Vërtetë është një punë e mirë, një analizë lidhur me asistencën në votim. Analiza, sjellë në pah disa mangësi, vecanërisht rasti në komunën e Prizrenit, kur një 12 vjeçar asiston në votim, e kur dihet që edhe ligjërisht nuk i

takon, domethënë pa mbushur 18 vjet...Pastaj, po një raste tjetër në komunën e Prizrenit kur një 13 vjeçar, asiston në votim, dhe kemi edhe rastin në komunën e Prishtinës kur një votues asiston në votim me dokument – pasaportë franceze...

Po ashtu, i kemi 149 persona që kanë asistuar në komuna të ndryshme duke mos qenë në LPV në të komunë ku ata kanë votuar...Pra, përveq punës së mirë, analiza sjellë edhe mangësitë gjatë procesit zgjedhor...

Rekomandimet, janë të mirëseradhura, tha më tej z. Elashani duke potencuar komunat me shifra të larta të asistimit: Prishtina me 4000 votues, Pejen me 2900, Malishevën me 2200, si dhe Lipjanin me 2297...

Duhet të kemi parasysh, pra që këto rekomandime të zbatohen, edhe nga KOZ është kërkuar që rekomandimet të zbatohen...

**Eshref Vishi:** Përmbajtja e këtij raporti bazohet në raportin e vazhimit të zgjedhjeve nga OSBE të vitit 2019, si dhe në raportet e organizatave të brendshme, dhe të dhënat e nxjerra nga Libri i Votimit në cdo vendvotim...Objekti I trajtimit, ka qenë mosha dhe gjinia e votuesve me asistencë, si dhe personat që kanë asistuar gjatë votimit. Metodologjia e përdorur gjatë kësaj analize, është metoda e mostrimit e cila ka nxjerrë në pah ¼ e e gjithë vendvotimeve, domethënë 25% e vendvotimeve...

Po ashtu, nxjerrja e të dhënave për personat që kanë asistuar pesonat në nevojë, edhe për këta është përdorur e njëjta metodë...pra kemi 25% të rasteve që janë evidentuar në këtë raport...

Të dhënat e personave që kanë asistuar, përbëjnë njëfar lloj shkeljeje të procesit zgjedhorë në ditën e zgjedhjeve dhe se, është arritur që KQZ në njëfarë mënyrë që ti qesë në dritë gjithë ato shkelje gjatë këtij procesi të votimit...Në raport, ka raste që është asistuar më shumë se njëherë, është asistuar me mbiemër të njëjtë (të asistuarit dhe asistuesit), ka raste kur asistuesi ka qenë nën moshën 18 vjeqare, rasti me shtetësi të huaj që u përmend etj.

Rasti i rënd për mua është edhe fakti kur, vetë anëtarët e KVV kanë toleruar këto raste...Do të pajtohem me gjithë rekomandimet, pork am propozim: të hartohet edhe një rekomandim, dhe të evidentohen gjithë pjesmarrësit e KVV dhe të mos jenë ma në trupat zgjedhore...pra, të hyjnë në listen e zezë...dhe këto, të mos përsëriten ma...

**Čemailj Kurtiši:** Ky raport është i punuar mirë, vërtetë është një shembull, dhe bazohet mbi gabimet që në të ardhmen nuk duhet të përsëriten...E kam parë raportin, dhe nuk e kam të qartë si janë lejuar personat 12, 13 vjet të asistojnë, pra kanë qenë

për të ndihmuar fizikisht, apo...? Njëmend, për mua nuk është e qartë, por mbi të gjitha, ky raport është jashtëzakonisht i mirë...

**Ibrahim Selmanaj**: Ju përgëzoj për punën e bërë...! Këtu është prezantuar një realitet cili është aktualisht me gjendjen e votave me asistencë, është një numër i madh i votave me asistencë... Rekomandimet që dalin nga raporti duhet ti përfillim, dhe sigurisht me qasjen e gjithë mekanizmave, ne mund të kemi një numër më të vogël...pra, ta evitojmë këtë dukuri...

**Sami Kurteshi**: E kemi këtë raport, dhe nuk po shoh që ka kundërshtime thelbësore. Unë propozoj që, në të vërtetë, të organizohet një tryezë me gjithë aktoret që të diskutohet me institucionet, organizatat dhe personat që involvohen në procesin zgjedhor, kanë interes për procesin zgjedhor...Për mua, kjo punë ka rëndësi edhe për publikun...

**Arianit Elshani**: Kjo që tha z. Kurteshi, është diskutue edhe në KOZ dhe, kemi kërkuar që pasi që të aprovohet këtu në KQZ, të shkoj në diskutim publik dhe besoj, do të merren rekomandimet e tjera...

Më vjen keq që po e përmendi, por vetëm shikojeni një rast në Prizren: prej 746 votuesve me të drejtë vote, 322 votues kanë votuar...Prej tyre, 76 votues kanë votuar me asistencë, një përqindje prej 23%. Kjo nënkupton që komisionarët dhe kryesuesit e VV, duken që kanë qenë të papërgjegjshëm...

Këto fakte, duhet të merren parasysh, dhe të merren masa...sepse, të mos përmendim faktin që persona të ndryshëm kanë shkuar nga një komunë në tjetër për të asistuar...! Ndoshta, në të ardhmen duhet të bëhet një "votim online" dhe i njëjti, të mos mund të shkoj në vendvotim tjetër...

**Alim Rama**: Kryesorja, këtu janë rekomandimet... Për mua, është me rëndësi që njerëzit të informohen...Asistuesit, nuk jam i bindur që është shkelje ligjore nëse ata asistojnë më shumë se njëherë... Pra, edhe ne duhet ta kryejmë punën tonë si KQZ...t'i informojmë njerëzit para se me fillua procesi... Për shembull, pika 6, te rekomandimi, në doracak për zgjedhjet nuk përmendet me specifika që është shkelje legale, përmendet vetëm se një aistues mundet me votue njëherë, dhe mundet me zgjedhë një person që është në rend...

Ne, nuk jemi të sigurve që procedurat në KVV janë zbatuar si janë në doracak...Duhet të shkojmë hap mbas hapi, për zgjedhjet e ardhme të ketë sa më shumë informacion, të ceket edhe dënimi...sepse, tash kemi mbi 20 % të VV që kanë bërë shkelje...! Madje, edhe në zgjedhjet në Podujevë ose Mitrovicë të Veriut, të ceket se asistimi është shkelje dhe të shkohet me dënime...

**Valdete Daka:** Një shpjegim: asistimi dy herë, nuk është vepër penale. Ndoshta, është shkelje procedurale, mirëpo jo vepër penale...

**Nenad Rikallo:** E kam lexuar raportin, është mjaft i detajuar dhe është për falënderim! Ka shumë shembuj konkret, dhe mendoj që imponon analizë dhe zbatim të rekomandimeve... Rekomandimet, të jenë pjesë e trajnimeve: çka duhet të bëhet, dhe çka nuk duhet të bëhet...! Të jenë të obligueshme, ato që duhet të jenë! Janë shembuj konkret, çka nuk duhet të bëhet! Kur të filloj faza e informimit, kampanja e informimit nga KQZ, është shansi që t'i paraqesim çështjet, t'i informojmë njerëzit, sepse mendoj që edhe nuk e dinë. Lutja ime është që, ky të mos mbetet vetëm një raport por, të shfrytëzohet maksimalisht...

**Arianit Elshani,** ndër të tjera, në diskutimin e sërishëm lidhur me raportin, theksoi faktin se “faji” në njëfarë mënyre bie mbi kryesuesit dhe komisionarët, dhe se përgjegjësia e tyre është e evidente...! Megjithatë, ai tha se, vërehet tendenca e rënies së kësaj shifre të asistencës. Nga 58584 sa ka qenë vota me asistencë në zgjedhjet e 2017, në zgjedhjet e 2019, kjo shifër ka rënë në 55 961 persona...

**Valdete Daka:** Atëherë, me krejt analizat dhe shqyrtimet që bëmë, kush është për miratimin e këtij raporti ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë raport.

#### **4.Këshilli për Çështje Ligjore:**

**Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Klinë, Pejë dhe Prishtinë:**

**Arianit Elshani**: Këshilli për Çështje Ligjore, ka shqyrtar zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal të Klinës, dhe pas shqyrtimit të gjithë procedurës ligjore, me 4 vota për, dhe 1 kundër, e ka sjellë në KQZ rekomandimin për zëvendësim.

**Valdete Daka**: Atëherë, kush është që Lirim Gashi nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re, të emërohet anëtar i KK të komunës së Klinës, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm, z. Avni Gashi.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim me 2 votë kundër ( Alim Rama dhe Sami Kurteshi)

**Valdete Daka**: Kush është që Bekim Morina nga subjekti politik LDK, të emërohet anëtar i KK të komunës së Pejës, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm, z. Rexhep Kurtbogaj.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim me 2 votë kundër ( Alim Rama dhe Sami Kurteshi)

**Valdete Daka**: Kush është që Kreshnik Smajlaj nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, të emërohet anëtar i KK të komunës së Prishtinës, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm, z. Yll Bogaj.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim me vota unanime.

**5. Të ndryshme !**